



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Priredat - Promjenjeno Me Dan:	13-05-2025		
Nr. Izvještaj Ora/Broj	Numar Broj	Sifračni Prilog	Vlera Vrednost
01-	066/01-	442	



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrta e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershori 2008), dhe të nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -V- të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datën **19.05.2025** (e Hënë), duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal te objekti i vjetër i komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:


## R e n d d i t e

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025.**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirimin nga pagesa e punonjësve të policisë së Kosovës për shërbimet që afrohen në qendrën e Mjekësisë familjare dhe institucionet e tjera shëndetësorë që menaxhohen nga komuna e Vitisë.**
- Informatë për Manifestimin Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2025".**
- Informatë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë.**

Viti, më 13.05.2025

Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### NGA MBLEDHJA E KATËRT E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **18.04.2025 (e premte)**, në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkyetar i komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i kuvendit komunal), z.Ilir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, z.Majlinda Shabani, z.Zyrafete Rama, z.Zejnepe Osmani. Morën pjesë edhe drejtoret e drejtive. Pasi u konstatua se ka anëtarë për kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për nënkyetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtoret që janë prezent në këtë mbledhje dhe ju të tjerë pranishëm! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e katërt të rregullt të KPF-së! Pra, materialin e keni marrë me kohë, gjatë kësaj periudhe nuk kemi pas ende konfirmim të ligjshmërisë të atyre vendimeve që i kemi miratu. Para se me hi në rend dite, hapi diskutim, nëse ka jasht rendit të ditës.

**z.Ilir Zuka:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Dua të ju njoftoj që, nesër kemi 19 prillin, ditën e dëshmorit të Pozheranit, Mejdi Korrrani. Ju ftoj që në ora 10 të jemi në homazhe të gjithë. Kam dhe një shqetësim tjetër. Në oborrin e shkollës filllore dhe të mesme, kompania që ka përfundu shkollën ka lanë një deponi të madhe të bërllogut. Kam marrë informacione që kanë kërku mjete nga prindërit për me hjakë atë deponi. Marrëveshja ka qenë që, pasi të përfundohen të gjitha punimet, atë deponi e ka obligim me e hekë kompania që i ka grumbullu aty. Ajo ende ekziston aty, dhe dua të ndërhyhet. Në mbledhjen tjetër do të ua sjellë edhe me foto, që ta shifni ndoshta dhe do të kritikohem nga dikush, por këtu kemi edhe mësimdhënësen në atë shkollë, e dinë edhe kjo se për çka po flas. Realisht mësimdhënësit bashkë me drejtoreshën janë duke e bërë një punë të jazhtëzakonshme, por që janë tu pas probleme me kanalizimet, ujësjellësit dhe gjithçka që është brenda shkollës. Ministria na ka pas premtu që, kompania ka 1 vjet përgjegjësi për mirëmbajtje ne të ketë kujdes me shkollën që mos të prishet. Këta janë tu bë të pamundur me mbajt vetë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë e di që nëse hyhet në shkollë pa u bërë pranimi teknik, kompania më nuk merrë obligim. Këtë problem kemi pasë ne te shkolla e teknikes.

**z.Jakup Demiri:** Këtu te pika e katër, informatë mbi kontratat e papërfunduara në tri vitete e fundit. Ne kur kemi diskutu më herët që me sjellë si pikë të rendit të ditës, ka qenë për projektet e papërfunduara në Komunën e Vitisë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ne kemi kërku një informatë për kontratat e papërfunduara.

**z.Majlinda Shabani:** Ne kemi kërku tash e sa kohë raportin dhe një përbledhje të të gjitha punimeve që janë bërë në Komunën e Vitisë, që kanë dhe nuk kanë pranim teknik. Unë po pajtohem me Jakupin dhe tek pjesa e kërkesës me shkrim, se nuk ka nevojë me bë kërkesë me shkrim, përderisa në çdo seancë të kuvendit komunal, në momentin që adresohemi te x projektet dhe kërkoj që këtu me bë raportime, përgjigjja e nënkyetarit është që duhet me ju referu inxhinierave, se ata e dinë me saktësi punimet që jan bërë. Përpos kontratave të papërfunduara që i ke në këtë periudhë 2022-2024, është një kohë shumë e shkurt dhe nuk mundesh me i përfshi

krejt projektet që janë bërë në Komunën e Vitisë me i diskutu veq për këto 2 vitet e fundit, dhe në këtë rast kërkesa me u sjellë në atë mënyrë si juve ju konvenon. Edhe tjetra, kemi dhe punime në Komunë të Vitisë, që pas raportime në kohë më të gjatë ose duhet me sjellë për projekte të papërfunduara, që edhe ne me pas kohën që me i bë pyetjet për krejt projekte që mendojmë ne me i ngritë si çështje dhe që mendoj që një seancë ka me qenë pak me trajtu këtë pikë, dhe kur kemi këto te pika, unë nuk kisha me qenë e pajtimi me u diskutu kur janë tu u diskutu dhe pasqyrat financiare për peridhën 3-mujore. Dhe tjetra që dua të ju referohem është, drejtori i shërbimeve publike me njoftu nëse ka pas kohë me dalë nëpër fshatra, në teren, dhe me pa se si është gjendja me mbeturina. Sa i përket rrugëve dhe kanalizimeve, a e kanë ndonjë listë kur e dimë ato kanalizime që kanë problem, sepse ne e dimë që çdo reshje në Komunën e Vitisë, rrugët bllokohen dhe nuk mundesh me kalu.

**z.Basri Aliu, drejtori:** Përvendetje për të gjithë të pransihmit! Majlinda, ne çdo ditë jemi në teren. A është shqetësuese çështja e mbeturinave, e njerëzve të pandërgjegjshëm që e hudhin, fakt që është. Për këtë seancë kam përgatit një informatë lidhur me manxhimin e mbeturinave që e kërkun, edhe pse nuk e kemi sjellë me kohë, edhe pse "Ekohigjiena" e ka sjellë me vonesë. Tani është e gatshme, nëse e shifni të arsyeshme me shti në rend të ditës, mund të diskutojmë për secilin fshat veç e veç, se sa janë në sistem të menaxhimit të mbeturinave në çdo fshat. Dje kemi pas një diskutim me një përfaqësuese të Gizit, që ishte konsulente e jashtme dhe po bëjke raporte për menaxhimin e mbeturinave dhe mes bashkëpunimit në mes këtyre kompanive të cilat i mirëmbajnë menaxhimin e mbeturinave, ajo në rajonin e Gjilanit jeni më të suksesshëm në këtë pjesë. Nuk duhet me qenë të kënaqun ata pse kanë thanë, por ne duhet me bë pyetje se sa jemi të angazhumi këta që jemi prezent lidhur me parandalimin e këtyre. Për kanalizimet, ka defekte, por defektet i bajnë edhe qytetarët, sepse në disa vende i kanë futë dhe shirat atmosferike, d.m.th të qative në kanalizim, në momentin që bie shi ose të reshura, atëhere mbushet ajo dhe dika ka me shpërthy. Aty ku ka telashe tjera, ne ku kemi njohuri, aty ku ka në meanxhim "Hidromorava", ata kanë për obligim, ndërsa në fshatra të tjera të cilët nuk janë në menaxhim të tyre, intervenojmë dhe i menjanojmë ato probleme që të janë funksionale ato kanalizime.

**z.Illir Zuka:** Edhe në rrugën Pozheran-Sllatinë kemi dërgu bashkarisht një kërkesë me nënkomandantin e Stacionit Policor në Pozheran. Kemi kërku me qitë viaja të bardha për këmbësorë dhe shenja për 30 km/h. Vitin e kaluar kemi marrë mirën johje. Një ndër fshatrat që ka mbajt pastertin ka qenë Pozherani në nivel regjioni. Kam qenë si administrator.

**z.Jakup Demiri:** Kjo puna e arsyetimit që po bëhet këtu, ne e dimë se sa bërllog kemi, në vende tjera nuk i dijë, është mirë me na sjellë dokument, në këtë rast nëse e ka shpallë një organizatë, nëse Komuna e Vitisë është më e pastërtë. Ne e dimë se sa ka bërllog në Viti. Kemi një problem se, nuk kemi dhe ku me i qu, nuk kemi nda kurrë hapësirë, nuk i kemi ofru qytetarëve mundësi se ku me i hudhë. Dhe për kanalizime në Smirë ka gati 12 vite, pranim teknik nuk ka. Tash, a ka rregullore apo jo për këta qytetar që ujërat atmosferike i shtinë aty dhe që ua ndalon a keni ndonjë emër të dikujt që jeni marrë me të, që ka bërë një telashe. Në Smirë kemi më së paku 10 familje në këtë kohë që kanë probleme me kanalizim, që ju mbushen podrumet. Ka njeri që nuk ka jetu 6 muaj në shtëpi të vetë për punën e kanalizimit. Kompania që e ka kry punën i ka marrë mbi 95% të parave. Kjo është ajo që ne nuk pajtohem, dhe tek ndriçimi publik i ka 3 vite që flasim për ndicim publik, gjithmonë e gjijnë disa qytetarë të pandërgjegjshëm i prekun, por nuk e ke asnjë emër dhe atë kosto që shpenzohet ditën që qe 3 vite asnjë emër nuk e ke. Janë disa probleme që nëse nuk mundeni me i rregullu të paktën me ditë ku është problemi, se ne aty jetojmë.

**z.Basri Aliu, drejtori:** Për mirëmbajtje të kanalizimeve po i kerthuroni punët në Viti. P.sh.: aty ku bënë menaxhimin e ujit "Hidromorava", ajo është detyrë e "Hidromoravës", nuk është e komunës, sepse qytetarët paguajnë për pjesë të kanalizimit, d.m.th mirëmbajtjen e ka "Hidromorava", nuk e kemi ne. Pozherani, Sllatina, Tresteniku, Sodovina e Jerlive, Sodovina e Qerkezëve është nën menaxhimin e "Hidromoravës", nuk është nën menaxhimin tonë.

**znj.Majlinda Shabani:** Kur po thua që po ka që po prishen prej qytetarëve, tash unë pres edhe inspektorët që janë me dalë në teren me i pa këto persona, ndoshta edhe me i ndëshku me një gjobë në momentin që po bajnë telashe, se nuk mundemi me hedhë fajin gjithmonë dikund tjetër.

**z.Basri Aliu, drejtori:** Fakt që duhet edhe inspeksioni me dalë, por nëpër fshatra tjera kemi një kompani

tjetër, e cila nuk është nën menaxhimin e "Hidromoravës". D.m.th e mirëmbajmë ne. P.sh.: të Smirës nuk e ka "Hidromorava". Ne ndërhyrë aty ku vijnë qytetarët ankohen.

**znj.Zyrafete Rama:** Drejtor, sa i përket mbeturinave, ne gjithmonë ankohemi që edhe drejtoria nuk punon sa duhet, edhe qytetarët nuk po janë të kujdeshshëm, mirëpo kam pas rast që më kanë pyet qytetarët ku me i hudh mbeturinat e forta, tani ku ja cakton, p.sh.: unë kisha kërku me i siguru disa kontinier të mdhaj që e bartin me kamion.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Ish plani që ka qenë zhvillimor komunal, i ka pas 3 lokacione, Devajën, Sodovinën dhe në Binç. Në mes Devajës dhe Radivojcit është parë që nuk ka qenë vend i duhur. Kemi reagu edhe ne që me u ndërpre ajo çështje, dhe drejtori javën e kaluar së bashku me kryetarin e ka pas një takim, se zakonisht në vendet përendimore, vendet të cilat kanë kulturë më të gjatë se tonën. Për kësi gjëra zakonisht aty ku marrin dhe, apo gurë, mandej i hedhin ato dhe i kthejnë në gjendje të mëparshme dhe ne jemi orient tani te Budrika, prandaj aty nuk ka mundësi në çdo lokacion me dërgu aty.

**znj.Zyrafete Rama:** Çka nëse dikush dëshiron me ndërru invertarin e shtëpisë, p.sh.: më pyet mu ku ja caktoj unë atë vend që me hudhë mbeturina. Ai patjetër e ka me i hedhë diku, as nuk është në faj qytetari, edhe pse e shef çka i thu që pse po e hedhë. Të thotë ku po ma cakton ti vendin ku ta qoj.

**z.Basri Aliu, drejtori:** Nënkyetari e përmendi që janë të caktume në 2011 me kuvend vendet ku mund të hidhen mbeturinat e ngurta. D.m.th e kemi në Devajë, Sodovinë të Qerkezëve, por edhe te kalaja e Binçes. Te kalaja e Binçes kemi intervenu që mos me u hudhë, sepse vend historik, turistik dhe afër rrugës. Këto 2 vende tjera, ata që kanë kërku i kanë hedhë, por a janë vende të mira nuk janë, por këtu nuk është problemi i shërbimeve publike, por i Drejtorisë së Urbanizmit me harta zonale me percaktu vendin. Në takimin që patëm, që e përmendi nënkyetari, po mendojmë këtë gropen që është në Radivojc afër varrezave, ku janë marrë zhavorr e gurë për rrugë, me bë si deponi të mbeturinave të ngurta, në mënyrë që ta eleminojmë rrezikun, por të ja kthejmë pamjen e mëparshme, por problemi është që pronat nuk janë krejt të komunës, prona është edhe e pylltarisë. Kemi pas një takim edhe me pylltarinë, kemi përgatit një kërkesë që me ju drejtu Agjensionit të Pylltarisë, me na leju që atë ta bëjmë si deponi të materialeve të ngurta, që ta kthejmë në gjendje si ka qenë.

**z.Ramadan Deliu:** Përshtendetje për të gjithë të pranishmit! Këtë pikën që e votum për 50 ari në Binçë: a është kjo për riciklim të mbeturinave?

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Ajo është përfabrikë.

**znej.Zejnepe Osmani:** Përshtendejte për të gjithë të pranishmit! Kohëve të fundit kam has shumë thyrje të dritave, sidomos në lumin "Morava": a ka mundësi me u zbulu këta njerëz? A ka ndonjë kamerë? Se përpos dritave që thehen, ka edhe ulëse që janë thy dhe ato të mbeturinave.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Shumë e vërtet që ka vandalizëm në thyrjen e ndriçimit publik, por jo vetëm ndriçimit, por edhe shportave të mbeturinave, ulsëve e të gjithave, por është punë e policisë. Ne kemi raportu, se po na ndodhin këto probleme. Policia do të marrë masa. Sa do të merrë. A, nuk muj me dhanë këtë informatë unë, se nuk e di.

**znj.Majlinda Shabani:** Këto raste që janë tu ndodhë, normal që është puna e policis mi evidentu këto raste, por të paktën sipas mendimit tim është mirë që edhe komuna me reagu, me bë pulbike. Në rastë se bëhet një dëmtim, Drejtoria për Shërbime Publike delë me një informatë publike, thotë: qekaq, rrëth kësaj ore ka ndodhë një dëmtim. Ne i ftojmë organet kompetente me u merrë me rastin. Në të njëjtën kohë i bëjmë thirrje qytetarëve të Vitisë, që mos me praktiku këtë gjest, që është tu vazhdu, tu i dëmtu këto shërbime publike që janë, pikërisht përfaktin që askush nuk është tu ndëshku dhe nuk është tu bë shumë e madhe dhe publike, po vazhdojnë me qenë këto të vazhdushme.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Publike janë bërë se, unë vetë kam reagu, kam thirrë Plus Televizionin që me shiku se si i kanë thy edhe pemët që i kemi mbjellë vitin e kaluar, që jan thy qëllimi.

**z.Ramadan Deliu:** Sa pare janë hargju me i vendos kamerat nëpër Viti? Hala asnjë rast policia nuk e kanë zbulu, përveç një rast që unë i kam parë, i kam thirrë policinë, i kanë zanë 3 fëmijë. Kjo mua më quditë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit për kontributin! Përë këtë seancë kemi parapa këtë rend të ditës:

**z.Hasan Aliu nënkyetar i komunës:** Përshendeje për të gjithë të pranishmit! Edhe pse kam kontaktu me zn.Zyrafete, por fizikisht po e shof këtu, dhe ngushëllime për nënën. Java që ka shku kam qenë 8 ditë në mungesë dhe ka disa propozim vendime, në rast se ju i lejoni për kuvend, do ta ketë rëndësinë e veçantë gjithësecili. Një ndër ta është, propozim vendim për mbeshtetje financiare në shumë prej 3500 euro sindikatës të të punësuarve të shërbimit civil të Komunës së Vitisë. Dhe tjetra, ne kemi pas shumë kritika rreth KEDS-it. Fatmirësish kishin kalu 2 trafa në Komunën e Vitisë, rrugës te xhamia. Më duket edhe një në Drobesh, dhe tanë pata takimin me përfaqësuesit e KEDS-it, që kërkojnë me urgjencë me i nda na që ata me fillu punën. Ju tregova që ka me shku në KPF. Me lejen e juaj unë duhet me i përgatitë 2 propozim vendime. Ndoshta sot nuk muj, por ka me tentu se ka me dalë gjeometri me i vendos pikat. Në rast se nuk muj për me i vendos sot, po e lë vetem si kopje të planit me shti veç parcelen si tërësi e për kuvend me i përgatit sipërfaqet.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përgatiti direkt për kuvend, se e kemi praktiku këtë edhe më herët.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Dhe dy të cilat vijnë nga Drejtoria e Kadastrit. Një është të cilën e kemi pas, veç e kemi kalu këtë që ka qenë një propozim vendim për këmbimin e pronës. Është fjala te Xhavit Bajrami nga Verbani, që e kemi miratu, por tanë është akti final. Dhe një tjetër që nuk është përgatit, ishin ardh nënshkrimet e qytetarëve të cilët dëshirojnë me bë qeljen e një rruge këtu afér këtyre ndërtesave për me dalë në shesh. D.m.th janë diku 5 pika që kërkohet të hynë, dhe unë e pash obligative me kërkumët e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Me këto pikat që i kemi të propozume, këtë propozim vendim për ndarjen e mjeteve për 3 mijë e 500 euro për sindikatën e shërbyesve civil, që punojnë në Komunën e Vitisë, këta kanë bë kërkësë, mirëpo në mjete financiare nuk mundemi me nda pa ardh një propozim vendim prej Zyrës së Kryetarit. Nëse jeni për me shti në rend të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Sindikatat. Zakonisht paguajnë anëtarët në sindikatë.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Ata e kishin një shumë të mjeteve, por nuk e mbërrin nevojën që ata e kanë.

**z.Jakup Demiri:** Nuk e mbërrin, nuk kemi çka ju bëjmë. Sindikatat funksionojnë prej anëtarëve të vetë.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Unë jam nisë prej një variantës. Ju keni marrë vendim lidhur me shkuarjen e kuvendit. Edhe tash nuk më pritë me të thanë mirë nënkyetar se, ata mund me thanë që, nëse ata kanë shku edhe ne duhet me shku, se edhe ata kanë shku me mjete të komunës. Besoj që nuk do të ishte mirë me ndal. Si të doni, ju jeni ata që vendosni.

**z.Jakup Demiri:** Jo, paret nuk jan të komunës. Se kuvendi është i ndamë prej ekzekutivit.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Kuvendi i kujt është? Se thotë në ligj: dy organet e komunës janë kryetari dhe kuvendi.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë në aspektin ligjor po themë se, unë jam për. Shuma e mjeteve të këruara nga Sindicata e Administratës Komunale të Vitisë në shumën prej 3 mijë e 500 euro, do të sigurohet nga kodi buxhetor, subvencione dhe transfere nga Zyra e Kryetarit. Tash në aspektin ligjor unë nuk e di ndarja e mjeteve, subvencioneve nga kuvendi. Ne kemi pas kur kemi nda për atë qendrën në Gjilan, që na e kanë kthy. Thotë se: subvencionet jepen ose përmes konkursit ose kryetari i jep direkt deri në 500 euro. Aspekti ligjor, këtë mund me kthy negativ prej rastit të Gjilanit.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Ata kanë kërkua kështu. Unë ju kam thanë po, kuvendi vendos, zyret e ministrisë thonë, është ligjor apo nuk është.

**z.Ilir Zuka:** Unë personalisht jam pro. Nuk e di sakt për çka e kanë kërkua, por një material që na ka ardh kish shumë komuna që kan aprovu këtë vendim dhe ju ka miratu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë të hynë në rend të ditës me pikat tjera? Pra, me të gjitha votat pro pa asnjë votë kundër asnjë apstenim dhe kjo pikë hynë në redn të ditës. D.m.th pronat e KEDS-it po i shtimë direkt në kuvend. E kemi edhe këtë propozim vendim për këmbimin e pronës, d.m.th është procedurë. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, edhe kjo pikë hynë në rend të ditës. D.m.th i kemi 7 pika: pra a jeni që të miratohet rendi i ditës me këto pikat shtesë?

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunat Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Partesh, Kllokot, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë.
4. Informatë mbi kontratat e papërfunduara në tri vitet e fundit 2022-2024.
5. Informatë nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrotjtje të Mjedisit për lejet ndërtimore gjatë viteve 2021-2025.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe rendi i ditës me 2 pika shtesë.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

### 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë Komitetit për Politikë dhe Financa

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për pikën e procesverbalit. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet procesverbal? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

### 2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2025

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ju kisha lutë që, në seancat tjera të vijë drejtori apo drejtoresha në prezantimin e pikës që është nga drejtoria perkatese.

**z.Berat Zuka, zyrtar i Drejtorisë për Financa:** Përshtendejte për të gjithë të pranishmit! Për pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2025 kemi përgatit një material, dhe këtë material e keni marrë me kohë. Do ti hi në pika të shkurtra. Besoj që drejtoresha në kuend do të jetë. Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave dhe Ligjit për Financa i Pushtetit Lokal, komuna ka për obligim ta përgatis reportin financier 3 mujor, dhe në fund të vitit reportin vjetor. Ne si zyre kemi përgatit këtë material që është dorëzu, dhe shohim se në faqen 2 thuhet se, buxheti i alokuar dhe i shpenzuar te të gjitha programet buxhetore janar - mars 2025, mirëpo kur të vijmë te tabela e parë që shihet aprovimi ku kjo tabelë e paraqet reportin e financave, reportin vjetor, sepse ne si drejtori dhe në bazë të planit, por nuk e kemi prezantu në raport 3 mujor, por në raport vjetor, dhe do të shohim ta arsyetojmë pse është rapporti vjetor, sepse te disa rapporti i planit që ka qenë 3 mujor, janar – shkurt – mars, në bazë të vendimeve gjyqësore përmbarimore, e dimë se, 1 milion e 94 mijë euro janë marrë, janë marrë edhe në ato mjetet nëpër projektet kapitlae që i kemi pas të zotume dhe dorëzume në zyrat përkatëse, mirëpo thesari ka parapa që, këtë vit jo sikur vitin e kaluar, të merren mjetet e vendimeve të gjykatës dhe vendimeve përmbaruese nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, për procesin e kontratës kolektive, por janë marrë kryesisht nga shpenzimet kapitale, dhe kjo është pjesa e parë e aprovimit buxhetit vjetor në fondet burimore, grandet qeveritare, të hyrat vetanake të këtij viti dhe donacionet që janë bartë nga viti i kaluar. Tabela e dytë është pjesa e alokimeve, ku shohim që investimet kapitale janë të laokuara në vlerë prej 2 milion e 920 mijë euro, që d.m.th se, nga këto 2 milion e 920 mijë euro, 2 milion e 501 mijë euro janë marrë pjesën e parë, pjesën e pagume të obligimeve tona, dhe 1 milion e 94 mijë euro janë marrë për procesin e kontratës kolektive, pa shkresë tonën, pa i përditësu të dhënat e tona. Vet kanë ndërhy dhe i kanë marrë çka ne nuk mujmë me thanë se nuk kemi interferime, që projektet kapitale vetë t'i deklarojmë dhe të ekzekutohen jashtë qëllimit dhe kontratës, por departamenti i thesarit kështu ka parapa. Në faqen 20 janë të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe realizuara për periudhën janar- mars 2025. Këtu kemi një gabim teknik, rendi i dytë nga fundi, dhe kjo faqe duhet të ndërrohet kur të vijë materiali për kuend, dhe listën plotësuese shtjelluse për kuend. Nëse ka nevojë e keni të përgatitur që të ju bashkëngjitet materialit. Mos të hy më gjatë, materialin e keni marrë me kohë, për çdo pakjartësi e çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Prej këto 1 milion e 94 mijë euor që janë pagu vendimet për gjykata? A ka mundësi këto me bë ndarjen, sa i kanë marrë përmbaruesit e avokatat, dhe sa i kanë marrë mësimdhënësat.

**z.Berat Zuka, zyrtar i Drejtorisë për Financa:** Kemi landë 3 euro e gjysmë është borxhi, a 399 euro janë shpenzimet e përmbarimit. Për 3-mujorin e dytë e kemi problem me siguru këtë informatë por përvjetorin e sigurojmë, se ne kemi 2447 landë që ka dërgu thesari për përmbarime, mirëpo nuk e dimë se cila lëndë është ekzekutu. Për pa e marrë materialin direkt, çdo pagesë që e ka bë thesari, atëherë mundemi me ditë si në tërësi e kemi 2 milion e 155 mijë është totali që na ka ardh. Në janar 1 milion e 30-40 mijë janë shpenzime përmbarimore.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka më për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin Ndërkunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunat Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Partesh, Kllokot, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpë**

**z.Basri Aliu, drejtor:** Para së gjithash, ne për kuvend do ta bijmë një formë jo kështu, por do të jetë Plani Ndërkunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturiave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, por do të jetë një formë pak më të rregullt, por me qenë më e kjart. Ky plan ka fillu prej 2023-ës, ka qenë një vendim i kryetarit, që ka formu një komision, d.m.th çdo kryetar i komunës ka pas komision që kanë marrë pjesë nëpër trajnime të ndryshme ku është organizuar nga GIZ-i Gjerman. Qëllimi i këtij plani është që, deri në vitin 2045 parashihet se sa do të bëhet seleksionimi i mbeturinave për çdo periudhë kohore. P.sh.: e ke deri në vitin 2023, 20% klasifikimi i mbeturinave, mandej për 2040 - 45 parashihet një përqindje më e lartë. Po është çështja e seleksionimit të mbeturinave dhe forimit në rajon e një fabrikës që bënë përpunimin e tyre. Kjo është esenca e gjithë saj. D.m.th ky material voluminoz i është paraqitur edhe legjislativit që është edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por është edhe legjislacioni i Bashkimit European, që e parashev edhe na obligon që të jemi edhe ne pjesë e këtij plani, në mënyrë që t'i arrijmë ato pika që mund të hymë në Bashkim European.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Këtë plan a kanë me miratu krejt këto komunat.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Po krejt kanë me miratu, kjo unike është për të gjithë.

**z.Majlinda Shabani:** Për mua është shumë e mirëpritur kjo, veç e kam një mëdyshje me thanë jam pak si skeptike, se sa jemi të përgatitur ne për me qenë pjesë e kësaj me implementu këtë, se jemi tu folë për gjendjen reale se si e kemi në Komunën e Vitisë, vetëdijësimin e qytetarëve në çfarë pike jemi, dhe po folim për diçka që është shumë bashkohore.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Për çështjen e mbeturinave, ujësjellësit dhe kanalizimeve në Europë nuk mund me hy. Kjo është kusht. Tash për shpejtimin e hapave si e bëjmë, dhe është çështje që varet prej neve dhe prej mundësive dhe prej donacioneve, dhe prej Bankes Botërore sa ka me leju kredi të butë, por janë kushte që nuk mund me hy në Bashkimin European pa i rregullu këto 3 çështje. Është standart.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka më për debat, a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

### **4. Informatë mbi kontratat e papërfunduara në tri vitet e fundit 2022-2024**

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kemi përgatit një raport rrëth kontratave për 3 vitet të fundit. Materialin e keni marrë me kohë, janë të përshkruara përafërsisht arsyetimi, ose si qëndron gjendja rrëth këtyre kontratave. Keni informata shtesë te rubrika e fundit ku është, dhe cilat janë proces. Për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Shebull, një kontratë nuk përfundohet 10 vite, e ka afatin 1 ose 2 vite dhe mbetë pa pranim teknik, pa përfundim. Në aspektin ligjor si mbetë ajo, a mbyllët, se ne e dimë që një projekt mbyllët kur pranohet teknikisht, bëhet pagesa.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Aspekti ligjor është mirë. Në rast se ti i ke përcjell hapat nga mbikëqyrja, a ka pas defekte, a janë të përfshime. Në rast se ti ke ngecë në proces dhe nuk i ke marrë hapat e duhur, dhe kanë shkru tu shtu problemet ai kurr vien nara përfundimit d.m.th ti nuk ke marrë masa. D.m.th ka

projekt që e ka përcjellë një gjendje e tillë. Tash a mundesh me i thanë neglizhencë apo çka donë. Nuk di si i thuni, por projekt i tillë kur të vjen në fund, është detyrë e menaxherit të kontratës të njoftoj autoritetin, ose me bë një komision për pranim teknik, ose gjatë kohës 1 muaj para përfundimit ka sigurim të ekzekutivit, që komuna mund me intervenu me ja marrë sigurimin e ekzkutimit për penalizim. Nëse nuk i ke nxanë këta hapa, dhe ti ke ngecë, atëhere operatori lirohet nga penalizmi. Me daljen e afatit të kontratës, ne kemi probleme, sepse ai nuk ndihet i kontraktuar, ai e ka kry punën e vetë. Ti duhesh me marrë masa, d.m.th s'munesh me marrë masa tjera nëse ti në raport, një menaxher i yti nuk ka arritë me i përcjellë ata hapa për me i evidentu. Nëse ti nuk i ke qu me kohë vërejtje dhe nuk e ke bë një CV, se ai ka dështu në realizim të projektit, atëherë nuk mundesh me i bë asgjë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Tash projekt i nuk është përfundu. P.sh.: nuk janë bërë penalizimet krjet. Operatori nuk ka përgjegjësi, krejt e kuptueshme. Tash ka mbetë projekt i papërfunduar. Dosja e projektit ka mbetë e hapur, p.sh.: kanalizmi në Smirë nuk është mbyll, pranim teknik nuk ka pas kurrë, dikur është kry ajo punë, tash u bë një pjesë e lagjes është bërë projekt tjetër.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Nëse kemi mbërri deri aty apo kemi mbërri, del komisioni në pranim teknik, i banë projektet. Nëse ka vërejtje, ata duhet me thanë qekjo, qekjo duhet me u përmirësu dhe tanë i japin urdhër operatorëve që me shku me ndreq, e nëse të kanë ik afatet, tanë duhet me hi me një operator tjetër. P.sh.: nëse të ka ik kontrata, nuk ki argumete, nuk ki prova, matriali, operatori sillet në bazë të ligjit, thotë dënon nëse mundesh me me dënu. E përderisa nuk ki prova, argumete, nuk mun e dënon ose e kanë ditarin në libër ndërtimor, po nëse në libër ndërtimor meanxheri ditën që e ka bërë vërejtjen ditën e punës kur e ka bë ai e ka pas të shënume, plus duhet me pas vërejtje që e dërgon tek ZKA dhe te Zyra e Prokurimit. D.m.th duhet me pas informacionin e shkept që ka njoftu edhe organe tjera. Kur të mungojnë këto, ti je në një pozitë që s'mun merrë masa, nëse e penalizojmë, se ne mujmë me bë veprim tjetër, se e lidhum një kontratë tjetër dhe vazhdon, por kur ja nisë me këta hapa, ti je në aut, kur të bëhet ky problem, nuk ke zyrtar që e shtin në komision dhe mbetet problem i pazgjidhur.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Tash këto vërejtje nuk janë bërë me kohë dhe mua më intereson mos pranimi teknik, sa perqind me të drejtë me ja ndal mjetet. Nëse është 10%, a i mbulon defektet e projektit.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Varet, tash duhet me dalë me vlerësu organi.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Në aspektin ligjor kjo dosje mbetet e haptë.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Po do të jetë e hapur deri në një vendim tjetër që do të merret.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Tash në dosje të haptë nuk mundemi me lanë në pafundësi. A ekziston mundësia ligjore që një komision prej 3 veteve me vërejtje të cilat i ka pranimi teknik me ekzisitu me u mbyll dosja, nuk është me rëndësi kush është në pushtet, veç projekt me u mbyll, me thanë i ka këto defekte dhe me vazhdu në eleminim të asaj, se aty krejt keq nuk është.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Ti e bënë një vlerësim me komision, mirëpo ti ja qon operatorit, ai të thotë jo nuk është kështu, por kështu d.m.th ti bjen me një konflikt profesional të cilin duhesh me thirrë një organ tjetër për me vlerësu atë farë vlerësimi, që shembull ti e konsideron, ashtu dhe tash hapet diksutim dhe ajo mbetet pezull. Ne me operator kemi pas komunikime të vazhdueshme, mirëpo ai nuk pranon. Ti i thu kështu u vendos keq, ne kemi dokumente që e kanë përcjell edhe qytetarët. P.sh. kur e kanë lëshu një shakt, unë kam me e-mail që duhet me vendos një bazë, poshtë një pllakë, tanë me vendos shaktin, se nëse nuk vendos bazë, shakti flen dhe bjen në disnivel, d.m.th qarkullimi i ujrave të zeza është problem. Ai d.m.th qëtu ka ik, veç i ka lështu, tash duhet me hi te secila, duhesh me hi me mat disnivelin, matje gjeodezike, me këqyr cili shakt nuk funksionon dhe ku me ditë sa na delë. Problemi d.m.th është që kemi neglizhu në hapa, nuk i kemi përcjell mirë dhe kemi arritë këtu ku jemi. Ata thonë që është mirë, por jeni tu e bë për inat, aty shihet me sy që nuk është në rregull.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Shembull mbikëqyrësi. Pa i dhanë mbikëqyrësi leje, ai nuk mundet me shtru as shaktin pa e mbikëqyrë, ai nuk mundet me vendos gypin. Ne e kemi përcjell në Smirë me vite qaty kemi ingjizime me mijra fotografji ja kemi përcjell komunës, kemi pas shumë takime. Shembull, një projekt e penalizon një projekt që nuk e ka kry, dhe gjatë punës po i shtojmë punë shtesë, dhe ai po merrë edhe për punë shtesë, a është aspekti ligjor shembull që po merrë punë shtesë. P.sh.: ka qenë projekt 100 mijë euro i ka marë

10% punë shtesë, plus 10 mijë euro, ti prap po ja jepë 10 mijë euro, ai në fund është 0.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Tek kanalizimet kemi pak probleme, se ata janë ndër tokë, por mbi tokë që e shef që e ka shtru një pjesë, p.sh.: kemi marrë një aneks diku ose kemi bë një shtim të vlerës, ajo është konkrete, mundesh me shku me pa.

**z.Ilir Zuka:** A ka ligj që i dënon, se ajo po vazhdon. Ne e dimë që e ke kompaninë në fjalë, nuk dua me cekë me emra, ai ka vazhdu i ka marrë dhe 20 punë tjera, dhe prej 20, 19 i ka pa pranim teknik. Paraprakisht keve aty kur e ngrita shqetësimin për në Pozheran.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Gabim je, nëse i ke 19 tjera, tregoj cilat janë prej të njëjtët operator.

**z.Ilir Zuka:** Ne kemi pranim teknik për në shkollë, por kemi probleme të Jashtëzakonshme. Çfarë masa mundemi me marrë?

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Prej penalizimit, lista e zezë, deri në padi.

**z.Ilir Zuka:** A ka ndodhë që, Komuna e Vitisë të ndërmerr masa?

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Për pranimet teknike jo.

**z.Jakup Demiri:** Puna e pranimeve teknike, as unë nuk kam ndëgju për një kompani që nuk ju ka pranu projektin teknikisht, që është marrë masa ndaj kompanisë (nuk ndegjohet). Për kanalizimin në Smirë, është tmerr. Krejt e diskutum që, Ferat Kastrati thojke as mos më paguani, veç ndaleni se i merrni në qafë këta qytetarë. Qeverisjen në kompani e komunikon qeverisja. 3 vjet rend ka 120 mijë euro kemi pagu rrugë me asfalt përrugën e Pozheranit ka pasqyrja e deri tek Vinexi. S'ka pranim teknik dhe është pajtu kompania me rishtu dhe nuk e ka rishtu rrugën e Pozheranit, diku 200 metra, kurrë nuk e ka shtru. Një zyrtar e merrë rrrogën shumë, kushdo koftë mos e merr personale ti.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Cili zyrtar duhet me qenë më konkret. D.m.th unë jam këtu profesionist i punës time, unë jam tu fol konkret, fakte, materiale. Nëse ti mban fjalim politik, mbaj, por mbaj në kuvend. Këto çka i fole janë politike, se çdo send që thave thuaj kjo është konkret.

**z.Jakup Demiri:** Në përgjithësi unë jam tu fol për projektin që është gabim, nuk ka të bëjë me ty.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Po je tu fol me mu, unë përgjigjna.

**z.Jakup Demiri:** Unë kam pas fol 2017 për ujin e pijshëm në Komunën e Vitisë, kam shku te "Hidromorava", kam mbajtë takim dhe ata thanë me rritë kapacitetin e ujit, se në Smirë e patën shtru rrjetin e ujësjellësit. Kështu që, për me i ndreq rezervarët atje vynë 70 mijë deri 100 mijë euro, dhe e pashë që nuk e ka mendjen me e ba (**nuk dëgjohet**).

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Ka raste që mund me dështu, mirëpo në përgjithësi shumica janë kualitative dhe janë të testume.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kush është përgjegjës me i marrë masat, zyra jote apo e kryetarit?

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Po mua ma sjellin informacionin, unë ndërmarr masa. Shembull këtu rrugën te xhamia, dështoj, e ka pru, unë kam bërë urdhër, e ka shtru.

**z.nj.Majlinda Shabani:** Kjo rruga mbrapa këtu që është, si ka përfundu që me dalë me hecë mbrapa me vetura. Çka ka ndodhë me atë rrugë, a mundeni me na sqaru, a është për me lehtësu jetën e qytetarëve. Tash në aspekt të rregullimit të dokumenteve dhe në aspekt të procedimit që ke, aspektin tënd profesional. E para, këto arsyetimet që janë në secilin projekt që është i emërtum këtu, është krejt trubullt, nuk mundesh me i pa, përvèç se punimet e pa përfunduara, dhe unë kam pas problem me i lexu arsyetimet, janë shumë të vogla shkronjat, nuk mundesh me i pa. Një problem shumë i madhë, që mendoj që është përgjegjësi i jotja në aspekt të procedimi të projekteve që ti i ke si kompetencë me i procedu këto, dhe kritika jonë e vazhdueshme edhe si opozitë, d.m.th për këto punime që janë tu bë, sidomos në këtë 10 vjeçarin e fundit që është shndërru një far lloj praktike. Kjo mënyra e punimeve që është bërë shabllon në komunën tonë, dhe kjo është për me u shqetësu shumë, se ke shembull tash këto projekte 2-vjeçare, këto 2 vitet e fundit ki rregullim të kanalizimeve në Komunën e Vitisë, ki projekt 2-vjeçar. Tash e para, nuk kemi informacion se ku janë tu rregullu ato kanalizime. P.sh.: te rrjeti i ujësjellësit, në shumë lagje ka ndodhë që ai rrjet i ujësjellësit që është shtru, e ki pa pranim teknik dhe askush nuk ka përgjegjësi. E ke në fshatin Skifteraj, ndërsa tek kanalizimet, shumica e kanalizimeve, po themë që kohëzgjatja e tyre ndodh që prishet, dhe në moment që vjen një reshje, tanë dhe bllokohet komplekt, ajo rrugë është që më së pari ai punim nuk është bërë si duhet, dhe është puna te mbikëqyrja e punimeve. Tjetra është kualitetin që e kemi në Komunën e Vitisë, p.sh.: ti ke një projekti 2-vjeçar, përfundon një projekt për ato 2 vjet,

ndodhë duhet me intervenu në qat rrugë. P.sh.: pas 2 viteve prapë me intervenu duhet, prap tender i ri për atë rrugë që është kry apo si duhet. P.sh.: e ke rrugën në Sllatinë.

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Në rast se nuk është kryer puna mirë, përgjegjësia është e operatorit.

**z.Ilir Zuka:** A mundesh me ma spjegu problemin e trotuarëve në Komunën e Vitisë? Ne e dimë që kemi pas trotuar në Pozheran që ka qenë në 2020, nuk ka përfundu, është projekti i dytë që është shpall, d.m.th në 2024. Çka ka ndodhë me të që nuk po kryhen punimet?

**z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit:** Ka pas problem me buxhet operatori, e dinë ti, për me i dhanë urdhër duhes me ja lëshu paret.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka më per debat e qesë në votim. A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa a snjë votë kundër, asnjë abstenim edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

**5. Informatë nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për lejet ndërtimore gjatë viteve 2021-2025**

**z.Visar Demiri, drejtor:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në bazë të kërkesës së kuvendit komunal për një ionformatë për lejet ndërtimore gjatë viteteve 2021-2025 dhe taksat e paguara për to, drejtoria ka përgatit një informatë për këtë kërkesë. Besoj që materialin e keni marrë me kohë, për çdo gjë shtesë jam në dispozicionin tuaj. Një sqarim, këto janë leje te lëshuara jo të refuzuara. Ndërtimet pa leje, ato që shkelin, ato janë përgjegjësi e inspeksionit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka më per debat e qesë në votim. A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa a snjë votë kundër, asnjë abstenik dhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbështetjen financiare në shumën prej 3500 Euro për sindikatën (SPAK) e të punësuarve shërimit civil në Komunën Vitisë**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka më për debat, e qesë në votim. A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e luajtshme, e cila evidentohet në pronësi të Xhavit (Januz) Bajramit**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka më për debat, e qesë në votim. A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, dhe kjo pikë shkon në kuvend.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**



**REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA**

Primirar - Primirjeno Me Datan		13-05-2025	
Nr. Formular Orq. Broj.	Numri Broj	Shtetore Fondiq	Vlera Vrednost
02-	035/02-	441	



Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës ( Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011 , Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

### PROPOZIM VENDIM

#### PËR BARTJEN E MJETEVE NGA TË HYRAT VETANAKE TË VITIT 2024 NË VITIN 2025

##### I.

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin për bartjen e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara të vitit 2024 në vitin 2025 .

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-332 – Mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, neni 9 - të ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak , pika 1,2 , bilancet e pa shpenzuara të të hyarve vetanake të komunave, dhe pika 6 dhe 7 për Bartjen e Buxhetit Komunal në vlerë prej **230,520.86 €** në vitin 2025. Nga vlera e mjeteve prej 230,520.86 € , mjete të bartuna e të pa shpenzuara nga viti 2024 janë prej **26,664.81 €** ( të alokuara në kategori ekonomike dhe në programe sipas planit të buxhetit të vitit 2024 ) dhe rritje të buxhetit nga THV janë prej **203,856.05 €**.

##### II.

Bartja e Buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale propozohen të shpërndahen në këto kategori ekonomike :

1. Mallëra e shërbime në shumë prej	5,063.04 €
2. Subvencione e transfere në shumë prej	4,868.26 €
3. Investime kapitale në shumë prej	220,589.56 €

Të shpërndara në këto nën - programe buxhetore :

, Në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime shuma prej **5,063.04 €**, në nën-programet :

- Zyra e kryetarit (16033) shuma prej 863.04 €
- Shërbimet e shëndetësis primare ( 74950) shuma prej 4,200.00 €

Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere shuma prej **4,868.26 €**, në nën –programin :

- Zyra e kryetarit (16033) shuma prej 4,868.26 €.

Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale – në projekte ekzistuese shuma prej **220,589.56** në nën- programet :

**Buxhetimi (17533) shuma prej 192,421.56 €** në projekte:

- Participim i projekteve me donator kod (90552) shuma prej 100,000.00 €,
- Blerja e autoveturave për administratën komunale në Viti kod (58349) shuma prej 9,640.00 €,
- Rregulli i rrrethojave të shkollave( Bafti Haxhiu ,Halil Alidema) kod (52817) shuma prej 4,929.77 €,

- Ndërtimi i tribunave të stadiumit në fshatin Skifteraj kodi (56310) shuma prej 25,000.00 €,
- Ndërtimi i fushave sportive në Zhiti, Tërpez, Trestenik, Vërban, Smirë, Begunc, Gjylekarë, Ramnisht kodi (53855) shuma prej 50,981.79 €

### **Shërbimet e shëndetësis primare (74950) shuma prej 11,263 € në projektin:**

- Renovimi i ambulantës në Viti kodi (53893) në shumë prej 11,263.00 €.

### **Arsimi i mesëm ( 95160) shuma prej 16,905 € në projektin :**

- Riparimi i shkollave në Viti, Radivojc, Devaj, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiti, Goshicë, Vërban dhe Ramnishtë kodi ( 53880) shuma prej 16,905.00 €.

### **Arsyetim:**

Në kërkesën për bartje të mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, nuk ka ndryshim në strukturën e shpenzimeve të mjeteve të mbetur të pa shpenzuara nga viti 2024.

Komuna ka tejkualuar planin e të hyrave vetanake të vitit 2024 në vlerë prej 203,856.05 euro, (prej 4,200.00 € janë rritur mallrat e shërbimet , ndërsa, pjesa tjetër në vlerë prej 199,656.05 €, në shpenzime kapitale.

Bartja e të hyrave në vlerë prej 5,063.04 €, në kategorinë e shpenzimeve mallra e shërbime vlera prej 863.04 kan mbetur pa u shpebzuar dhe vlera prej 4200 € rritje në mallra e shërbime nga të hyrat e shëndetësis .

Bartja e të hyrave në vlerë 4,868.26 €, në subvencione e transfere bëhet se kanë mbetur pa u shpenzuar nga viti 2024 .

Ndërsa, bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vlerë prej 220,589.56 €, në tetë projekte e ekzistuese bëhet nga tejkalimi i planit të shpenzimeve kapitale, për pagesën e obligimeve në këto projekte për të cilar kërkohen mjete shtesë, të pa paguara të kryhen obligimet financiare .

- Participim i projekteve me donator kodi (90552) shuma prej 100,000.00 € për pagesën e projekteve të bashkëfinancuara me donator .
- Blerja e autoveturave për administratën komunale në Viti kodi (58349) shuma prej 9,640.00 €- obligim i pa paguar.
- Rregulli i rrethojave të shkollave( Bafti Haxhiu ,Halil Alidema) kodi (52817) shuma prej 4,929.77 €,
- Blerja e fotoaparabit digital profesional kodi (55192) shum prej 1,870 .00 €, obligim i pa paguar.
- Ndërtimi i tribunave të stadiumit në fshatin Skifteraj kodi (56310) shuma prej 25,000.00 €,mjete shtesë nga planifikimi i buxhetit .
- Ndërtimi i fushave sportive në Zhiti,Terpez,Trestenik,Vërban,Smirë,Begunc,Gjylekarë,Ramnisht kodi (53855) shuma prej .... 50,781.88 € obligim i pa paguar. \
- Renovimi i ambulantës në Viti kodi (53893) në shumë prej 11,263.00 €, obligim i pa paguar.
- Riparimi i shkollave në Viti, Radivojc, Devaj, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiyi, Goshicë, Vërban dhe Ramnishtë kodi (53880) shuma prej 16,905.00 €, obligim i pa paguar.

Viti  
Datë 13.05.2025

Kryetari i Komunës  
Sokol Haliti





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA**

Pranuar - Primiteno Me Datan: <b>30-04-2025</b>			
Nr. Formant Org Broj	Numer Broj	Shtope Broj	Vlera Vrednost
02-	035/02-	406	



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe sipas kërkesës nga Shoqata Sindikale e Policisë Rajonale në Gjilan, Kryetari i Komunës së Vitisë me datë 30.04.2025 paraqet këtë:

### PROPOZIM VENDIM

#### PËR LIRIMIN NGA PAGESA PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS PËR SHËRBIMET QË AFROHEN NË QENDRËN E MJEKËSISË FAMILJARE DHE INSTITUCIONET E TJERA SHËNDETSORE QË MENAXHOHEN NGA KOMUNA E VITISE

##### Neni I

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që ta shqyrtoj dhe aprovoj kërkesën e Shoqates Sindikale të Policisë Rajonale në Gjilan, për lirimin nga pagesa e punonjësve të policisë së Kosovës për shërbimet që afrohen në qendrën e Mjekësisë familjare dhe institucionet e tjera shëndetsore që menaxhohen nga komuna e Vitisë.

##### Neni II

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi, është kërkesës nga Shoqata Sindikale e Policisë Rajonale në Gjilan, e datës 11.03.2025.

##### Neni III

Për zbatimin e këtij propozim vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale në komunën e Vitisë.

##### Neni IV

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

PROPOZUES :

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISE

Sokol Haliti





SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS  
SINDIKAT POLICIJE KOSOVA  
KOSOVO POLICE UNION



## MEMORANDUM ZYRTAR

PËR: z.Sokol Haliti  
Kryetar i Komunës Viti  
z.Bekim Azizi  
Kryetar i Kuvendit të Komunës së Vitisë

PËRMES: PREJ: z.Ragip Ajeti  
Kryetar i Shoqatës Sindikale Policisë Rajonale Gjilan

Data 11.03.2025  
Nr. i Ref:

### LËNDA: KËRKESË

Me anë të kësaj kërkese i drejtohem titullit të lartshënuar që ta miratoj lirimin nga pagesa për punonjësit e Policisë së Kosovës, për shërbimet që ofrohen në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe institucionet e tjera shëndetësore që menaxhohen nga Komuna e Vitisë.

Prandaj kërkojmë mirëkuptim nga titulli i lartshënuar që ta miratoj lirimin nga pagesa për kontrolllet dhe nevojat mjekësore që mundësohen nga QMF Viti, për pjesëtarët e policisë së Kosovës që shërbejnë në Rajonin e Gjilanit.

Mbështetim shpresë se kërkesa e jonë do të shqyrtohet dhe do të realizohet si dhe të përkrahet nga Strukturat udhëheqëse të Komunës së Vitisë në bashkëpunim me Drejtorin e Shëndetësisë dhe institucionet vartëse të Drejtorisë së Shëndetësisë në Viti.

Si dëshmi kësaj kërkese i bashkëngjes Vendimin e Kryeqytetit të Prishtinës me nr 01-020/01-238142/23 të lëshuar me datë 28.11.2024 që Miratohet liriimi nga pagesa për pjesëtarët e policisë.

Si dhe Vendimin e Kuvendit Komunal Gjilan, të datës 27.02.2025 me Nr.016-16471/25 që miratohet liriimi nga pagesa për punonjësit e Policisë.

Me respekt,  
Me 11.03.2025  
GJILAN

Kryetar i Shoqatës Sindikale për Rajonin Gjilan  
Ragip Ajeti  
Nr. Tel 044/212-103

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. Mulla IDRIZI Pn. Gjilan - Kosovë  
Drejtoria Rajonale e Policisë



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primljenno Me Dana: 12-05-2025			
Nr. Logjanti Org. Broj	Numri Broj	Shtetje Pratit	Vlera Vrednost
12-	070/01-	631	

2025

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI  
DHE SPORT

**MANIFESTIMI  
TRADICIONAL KULTURO-  
SPORTIV “FLAKADANI I  
KARADAKUT 2025”**

**DKRS/ VITI**




**Republika e Kosovës**  
Republic of Kosova  
**Komuna e Vitisë**  
Municipality of Viti/Vitina  
**DrejtoriapërKulturë, Rinidhe Sport**  
Departament of Culture, Youth and Sports

<b>DATË/A:</b>	Maj, 2025
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal, Viti
<b>NGA/ZA/FROM:</b>	Z. Valmir Sahiti Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport 
<b>PËRMES/OD/FROM:</b>	Kryesuesit të Kuvendit Komunal z.Bekim Azizi
<b>C.C</b>	Kryetari i Komunës së Vitisë z.Sokol Haliti
<b>LËNDA:</b>	Informatë për Manifestimin Tradicional “Flakadani i Karadakut 2025 ”

## **Përmbajtja**

<b>I.</b>	<b>DKRS – TRUPA KOORDINUESE E MANIFESTIMIT.....</b>	<b>4</b>
a)	Ndarja e detyrave të Trupës Koordinuese.....	4
<b>II.</b>	<b>RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE.....</b>	<b>5-9</b>
a)	Aktivite Kulturore dhe sportive.....	7-9
<b>III.</b>	<b>RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT.....</b>	<b>9-10</b>
a)	Tabela e kostos totale buxhetore.....	9
b)	Tabela kahasuese (2024-2025) e shpenzimeve.....	10
<b>IV.</b>	<b>MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT DHE MEDIAT.....</b>	<b>10</b>

**b). Ndarja e detyrave të Trupës koordinuese:**



## **II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE**

### **a) Aktivitet kulturore dhe sportive**

- Hapja solemne – Dhezja e Flakadanit

Kemi organizuar dhe mbajtur manifestimin tradicional kulturo-sportiv “Flakadani i Karadakut 2025”, manifestim ky i cili është zyrtarizuar përmes Kuvendit komunal si ngjarja më e madhe kulturo-sportive në Komunën e Vitisë, në të cilin marrin pjesë nxënësit, sportistët, shkrimtarët, artistët dhe grupet artistike nga mbarë hapësirat shqiptare dhe më gjërë.

Ky ishte edicioni i 24-të me radhë, i cili u mbajt në saje mbështetjes së projektit: “Flakadani i Karadakut 2025”, nga institucionet komunale si dhe organizimit nga ana e Drjetorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv “Flakadani i Karadakut 2025” ka filluar më 24 mars, ku u bë hapja solemne e manifestimit me dhezjen e Flakadanit dhe është përmbyllur më 26 mars në mbrëmjen finale të festivalit mbarëkombëtar të ansambleve dhe shoqërive kulturore dhe artistike.

Në këtë manifestim përvec udhëheqjes komunale dhe shoqatave të ndryshme prezantuan edhe deputetët e parlamentit të Kosovës, zyrtarë qeveritar si dhe mysafr të shumtë nga Kosova, Shqipëria, Lugina e Preshevës dhe Maqedonia e Veriut

Edhe në këtë edicion, pati risi dhe prurje të reja të cilat ishin në harmoni me karakterin e manifestimit tradicional kulturo-sportiv “Flakadani i Karadakut 2025”.

### Aktivitetet Kulturore dhe sportive:

- **Garat regionale të recituesve** – u mbajtën në Sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” në Viti, më 25 Mars 2025 me fillim në ora 11:00 Në këto gara prezantuan nxënësit e shkollave të mesme të komunave: Kamenicë, Gjilan, Viti dhe Kaçanik. Juria profesionale e përbërë nga përfaqësuesit e komunave përkatëse, vlerësuan që vendi i parë t'i takoi nxënëses nga Dardana Yllka Pireva, kurse vendi i dytë iu nda nxënëses Egzona Shabiu, ndërsa me vendin e tretë u shpërblye Ejona Zeneli.
- Për të gjitha shkollat pjesëmarrëse, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si organizatore e manifestimit, ndau falënderime.
- **Ora e Madhe Letrare** – u mbajt në sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” në Viti, më 26 mars 2025, me fillim në ora 11:00 Ku prezantuan shkrimitarë, poetë nga mbarë hapësira shqiptare. E organizuar në kordinim me Shoqatën e Shkrimitarëve “Ramadan Musliu” e cila hapi konkursin letrar, ku me poezitë e tyre kanë konkuruar poetë e shkrimitarë të cilët janë kualifikuar për Orën e Madhe Letrare dhe janë botuar në revistën “Flakadani i Karadakut 2025”.

Juria profesionale në përbërje prej 3 anëtarëve me kryetare Migena Arllati, ka vlerësuar poezitë më të mira të shkrimitarëve konkurrues të Orës së Madhe Letrare- “Flakadani i Karadakut 2025”.

Me çmimin e parë u nderua shkrimitari dhe poeti Ramë Oranca me poezinë “Rapsodi e 1432 engjujve”, çmimi i dytë i takoi Bajram Ali Selimit- Poezia ””Pesha e Flamurit”, kurse çmimi i tretë u nda për poeten Mimoza Zejnallahu nga Vitia.

Kurse çmimi kryesor “Flakadani i Karadakut” iu nda poetit Sabit Rrustemi nga Gjilani me poezinë “Pikëlon pranverë gjaku”.

- **Festivali Gjithëkombëtar i Shoqërisë Kulturore e Artistike** – u mbajt nga 24 - 26 Mars – prezantuan 12 -të Shoqëri Kulturore artistike nga Kosova, Shqipëria, dhe Maqedonia e Veriut, ku hapjen e festivalit e bënë solistët e mirënjohur Doarsa Sopa dhe Ismet Bexheti.

Mbrëmja e parë e festivalit, më 24 Mars:

Nr.	<i>Ansambl, Grupi artistik, Shoqëria Kulturore</i>	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	"Kemajl Azizi"	VITI	<b>Jashtë Konkurrencës</b>
2.	"Shqipet e Vogëla"	Mitrovicë	✓
3	"Jahi Hasani"	Çegran	✓
4.	AKV "Ilirida"	Shtime	✓

Mbrëmja e dytë e festivalit, më 25 Mars:

Nr.	<i>Ansambl, Grupi artistik, Shoqëria kulturore</i>	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	"Jonuz Ramadani"	VITI	<b>Jashtë konkurrencës</b>
2.	"Selman Kadria"	Istog	✓
3.	"Gryka Kaçanikut"	Kaçanik	✓
4.	"Gurra e Kurbinit"	Laç- Shqipëri	✓
5.			

## Mbrëmja e tretë e festivalit, më 26 Mars:

Nr.	Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	Q. K. "Anamorava"	Viti	Jashtë konkurrencës
2.	"Deçani"	Deçan	
3	"Kastriotët"	Ferizaj	
4.	"Shotë Galica"	Drenas	
5.	"Mati"	Shqipëri	
.			<u>Mysafire e festivalit</u>

Juria profesionale në përbërje: Mehmed Xhemajli koreograf, Sami Piraj muzikolog dhe Mustafë Lamallari profesor i muzikës, vlerësuan dhe ndanë 3 vendet e para, çmimin special dhe atë jubilar të Festivalit Gjithëkombëtar të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore Flakadani i Karadakut 2025"

Vinden e parë iu nda AKV "Mati" nga Shqipëria, vendi i dytë AKV "Kastriotët" nga Ferizaj dhe vendi i tretë i takoi SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi. Ndërsa me çmimin special u nderua AKV "Gryka e Kaçanikut" nga Kaçaniku.

- ✓ Më 26 Mars, me fillim nga ora 10.00, u bënë homazhe dhe vendosja e kurorave me lule te varrezat e dëshmorëve – Dëshmorit Nijazi Azemi – Komandant Mjekrra.

## Aktivitetet sportive:

- Garat sportive të shahut
- Garat sportive në gjimnastikë
- Garat sportive të basketbollit
- Garat sportive në futboll të vogël
- Haiking

Ku të gjitha ndeshjet u zhvilluan gjatë rrjedhës së manifestimit Kulturor dhe Sportiv "Flakadani i Karadakut-2025".

### III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT

**a) Tabela e kostos buxhetore:**

Fondi burimor	Lloji i shpenzimit	Kostoja në €
Komuna e Vitisë/DKRS	Akomodimi	580.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Zërimi	755.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Dreka dhe Darka (Shujta për grupet artistike dhe sportive)	7,170.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Plus TV	1,753.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Shtypja e materialeve grafike katalogë, cerada citillajda, rollop, postera, shtypja në bez e flamujve beza, gravura, fotografi etj.	1,980.00 €
<b>Totali:</b>		<b>12,238€</b>

"Flakadani i Karadakut 2024"	Flakadani i Karadakut 2025"
17,691.18 €	12,238.00
<b>-5453.18</b>	

krahasuese 2024/ 2025

Tabela


#### **IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT**

Mbështetësit: Komuna e Vitisë-DKRS VITI

**Mediat:** Manifestimi Tradicional kulturor dhe sportive "Flakadani i Karadakut 2025", u mbulua tërësisht nga "Plus Televizion" si dhe nga Tëvë1,T7,ATV, "TV Presheva", Zyra për Informim e Komunës së Vitisë si dhe mediumet tjera vendore.

**Rekomandimet:** Manifestimi Kulturo - Sportiv "Flakadani i Karadakut" si njëri nga aktivitetet më të mëdha kulturore dhe sportive në Viti të vazhdoj duke e identifikuar Vitinë gjithandej trojeve shqiptare.

Viti, Maj 2025





REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Pravniar - Pravljenje Me Dana		P-05-2023	
Nr. Organiit Org. Broj	Numri Broj	Shtopje Mbrojtë	Vlera Vrednost
09-	16/06	635	

# Informat për menaxhimin e mbeturinav në Komunën e Vitisë

## I.HYRJE

Kompania Ecohigjiena Sh.P.K Gjilan – Njesia punuese Viti, ka tē organizuara 4 Ekipë punuese në territorin e Vitise dhe shërbehen rreth 6213 klient, tē kategorive të ndryshme.

Për realizimin e Planit te punues, kompania ka tē sistemuar në këtë njësi punuese, gjithsej 21 punëtor, 13 prej tyre merren drejtpërdrejtë me grumbullim dhe transportim tē mbeturinave ndësa 8 janë staf indirekt që e ndihmojn këte Njesi punuese.

Me Planin e Menaxhimit tē Mbeturinave janë parapa 3 objektiva:

1. Zgjerimi i shërbimeve 100%; 2. Përmirësimi i efikasitetit dhe kostos operative; dhe 3. Menaxhimi i kategorive tjera tē mbeturinave - riciklimi i mbeturinave<sup>1</sup>;

**Misioni** - Bartja dhe deponimi e mbeturinave;

- Ngritura e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e aktivitetit tē saj;
- Mbulueshmëri në 100 % , e territorit tē komunave;
- Trajtim tē barabartë dhe qasje në shërbime për tē gjithë klientët;

**Vizioni** - Përfaqëson orientimin afatgjatë tē kompanisë si vijon:

- Ambient tē pastër dhe ekologjikisht tē qëndrueshëm;
- Shfrytëzimin racional tē kapaciteteve dhe resurseve njerëzore dhe tekniko-teknologjike;
- Hulumtimin dhe ofrimin opsjoneve përkatëse për zgjidhje tē kërkesave ekologjike;
- Reduktimin e mbeturinave, ndarjen si dhe kompostimin e mbeturinave tē kopshtit;

---

<sup>1</sup> Riciklimi - çdo operim tē përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera.

## I.1 Mbulimi me shërbime

Eco-Higjiena Sh.P.K Gjilan, Njësia punuese në Viti, mbulon me shërbime, qytetin dhe fshatrat:

Vendbanim	Ekonomitë familjare të shërbysyer	Bizneset e shërbysyer	Institucionet e shërbysyer
Pozheran	468	91	7
Sllatinë e Epërme	191	2	3
Sllatinë e Poshtme	116	2	2
Stubëll e Poshtme	63	2	2
Lubishtë	66	2	1
Binçë	33	2	1
Devajë	32	2	0
Letnicë	10	4	0
Buzovik	15	0	1
Shashare	9	0	0
Ballancë	39	0	1
Podgorc	37	0	0
Zhiti	60	0	1
Gushicë	81	0	1
Gërmovë	71	3	1
Drobesh	180	6	1
Kabash	178	1	1
Beguncë	138	0	2
Ramnishtë	65	1	2
Gjylekar	127	1	2
Remnik	83	0	2
Vërban	85	1	1
Novosellë	50	3	1
Ramjan	80	1	1
Budrikë e Epërme	86	4	1
Tërpezë	78	2	2
Radivojc	132	7	1
Sadovinë e çerkezve	13	0	1
Sadovinë e Jerlive	172	1	2
Smirë	251	6	2
Tërstenik	32	0	1
Viti	1126	372	23
<b>Gjithsej:</b>	<b>4167</b>	<b>516</b>	<b>67</b>

**Vërejtje:** Ne listë nuk janë te përfshirë klientët nga diaspora dhe rastet sociale te cilët janë te liruar nga pagesa e shërbimeve .

## **I.2 Orari i grumbullimit të mbeturinave**

Grumbullimi dhe bartja e mbeturinave organizohet 6 dite ne javë, gjatë tërë vitit, duke mos përjashtuar edhe festat shtetërore dhe fetare. Bartja e mbeturinave bëhet kryesisht në turnin e parë, duke filluar nga ora 05 deri ora 13<sup>h</sup>.

### **I.3.1 Bartja e mbeturinave nga amvisëritë**

Për këtë kategori të shërbimeve, bartja e mbeturinave organizohet me kamion special ndërsa klientët janë të obliguar që mbeturinat t'i fusin në shporta (120 litra, kontejner te perbashket) apo në qese plastike. Klientët janë të obliguar, shportat t'i nxjerrin buzë rrugës gjegjësisht jashtë derës së shtëpis, ndërsa transportimi i tyre bëhet me automjete speciale. Bartja e mbeturinave bëhet sipas orarit dhe terminit të caktuar kohor i cili nuk ndryshohet por mund shtyhet më së voni, deri në orët pas ditës. Në amvisni bartja e mbeturinave kryhet një ditë në javë.

Ekipi i punes perbehet prej: 1 Vozitesi dhe 2 punetor te cilet bejne zbrazjen e kontejnerve. Gjate sesones verore per arsyen te shtimit te mbeturinave nuri i punetorve sezonal rititet

Per shkak te infrastruktures rrugore ne te cilat nuk mund te hyhet me kamion, deri 100 metra distance klienete duhet ti sjellin vet mbeturinat e grumbulluara ne një pike te caktuar.

### **I.3.2 Bartja e mbeturinave nga objektet banesore**

Në bazë Planit Operativ, bartja e mbeturinave nga objektet banesore bëhet duke i zbruzur kontejnerët e llojeve (1,1m<sup>3</sup>), të cilët janë vendosur në pikën të përbashkëta grumbulluese dhe afér objekteve të banimit.. Sherbimi ofrohet 6 ne javë.

Ekipi i punes perbehet prej: 1 Vozitesi dhe 2 punetor te cilet bejne zbrazjen e kontejnerve.

### **I.3.3 Bartja e mbeturinave nga institucionet dhe bizneset private**

Bartja e mbeturinave në objekte të bizneseve ofrohet sipas planit favor dhe i mundësohet çdo klienti (Institucioni apo biznesi) që të ketë qasje të lehtë në shërbime, ndërsa disa biznese shërbehen së paku një here në javë. Kjo ndarje është bërë si rezultat i kategorizimit të rrugëve me prioritet kalimi dhe të rendit të dytë. Në pjesën dërmuese të bizneseve private, bartja e mbeturinave bëhet 6 ditë në javë. Ndërsa te disa ndërmarrjet komerciale dhe te një pjesë e bizneseve, bartja e mbeturinave bëhet sipas kërkësës së tyre përkatësisht sipas kontratës.

## **II. SISTEMI I GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE DHE MAKINERIA**

Grumbullimi dhe bartja e mbeturinave bëhet me Kamion speciale dhe shporta shtepiake të llojeve 120 litra si dhe kontejner 1,1m<sup>3</sup>, per tre kategori, si vijon:

### II.1.

Kamionët për grumbullim dhe transfer				
Kamioni Nr. 1	MAN 26 320 TGS	12	2008	06-583-FG
Kamioni Nr. 2	MAN TGA 26 400	10.7	2004	06-623-EE
Kamioni Nr. 3	MAN	10.6	2012	06-216-GH
Kamioni Nr. 4	MAN	10.6	2011	06-373-FK

### II.2.

Kontejnerë		
Kontejnerë 120 l	5962	(1- 3)
Kontejnerë 240 l	0	0
Kontejnerë 1.1 m <sup>3</sup>	185	3
Kontejnerë 4.5 m <sup>3</sup>	4	
Kontejnerë 15 m <sup>3</sup> - Transfer		

- 1 Grumbullimi i mbeturinave në amvisëri,
- 2 Grumbulli i mbeturinave nga objektet banesore
- 3 Grumbullimi i mbeturinave nga bizneset dhe institucionet

Në biznese dhe institucione është lënë mundësia, që organizimi i grumbullimit të mbeturinave të bëhet në bazë të **kërkesës së palëve** (kontejner ose shporta) dhe kontratës së nënshkruar me palët. Numri i zbrazjeve së kontejnerëve bëhet sipas marrëveshjes së arritur me palët. Me rastin e zbrazjes së kontejnerëve lëshohet dëshmi e veçantë (urdhëresë shërbimi) për kryerjen e shërbimit.

### FATURIMI DHE ARKËTIMI NGA SHËRBIMI I MENAGJIMIT TË MBETURINAVE VITI

Emri i operatorit	Kategoritë e klientëve të shërbyer	Faturimi (të hyrat)		Arkëtimi	
		Vlera €	Nr. i faturave të lëshuara	Vlera €	Nr. i faturave të arkëtuara
a	b	c	ç	d	dh
Eco-Higjiena Sh.P.K - Nj.Viti.	Amvisëritë	351,793.81	51,081	<b>291,861.92</b>	<b>10,378</b>
	Bizneset	69,016.97	5,246	<b>89,871.51</b>	<b>3,400</b>
	Institucionet	21,461.06	504	<b>21,696.09</b>	<b>311</b>
	Shërbimet e kontraktuara	27,588.21	280		
	TOTAL:	469,860.05	57,111	<b>403,429.52 €</b>	<b>14,089</b>

### MBETURINAT E GRUMBULUARA



Në vitin 2024 nga Komuna e Vitisë janë transportuar dhe deponuar gjithsej : 7112,65 ton, mbeturina të perziera komunale. Mesatarje e mbeturinave te gjeruara eshte 0,661 kg. koke banori.

1 .Janar	569,88
2. Shkurt	434,77
3. Mars	456,17
4. Prill	528,52
5. Maj	514,87
6. Qershor	505,94
7. Korrik	857,62
8. Gusht	971,79
9. Shtator	695,62
10. Tetor	615,92
11. Nëntor	384,32
12. Dhjetor	577,23
<b>Gjithsej:</b>	<b>7,112.65 ton</b>

Pervec mbeturinave te perziera, Njesia punuese ka deponuar edhe sasi te vogel te mbeturinave jo te konsumushme. Mbetje me aft skaduar Tarifa e deponise eshte 50,00 euro.

### III. LLOJET E MBETURINAVE

Grumbullohen disa lloje të mbeturinave: a) Mbeturinat e përziera komunale, b)Mbeturinat komerciale dhe c) Industriale.

Mbeturinat e amvisërisë janë ato mbeturina të cilat rrjedhin nga vendbanimet dhe objektet e ndryshme të banimit, duke përfshirë shtëpitë, vilat edhe institucionet (mbeturinat nga institucionet shkollore dhe parashkollore, kolegjet, drejtoret, objekte e fetare ) etj.

Mbeturinat komerciale rrjedhin nga lokalet që shfrytëzohen plotësisht apo kryesisht për tregti, biznes, sport, rekreacion apo argëtim, me përjashtim të mbeturinave shtëpiake dhe industriale.

Mbeturinat industriale janë mbeturinat të krijuara nga bizneset apo proceset industriale, ndërsa përjashtohen mbeturinat nga minierat ( guroreve dhe mbeturinave bujqësore). Njesia punuese nuk ofron sherbime mbeturinave të kopshtit dhe te ngurta ngurta.

### IV. SERVISI PËR RIPARIMIN E AUTOMJETEVE

Në kuadër të kompanisë Eco-Higjiena Sh. P. K Gjilan, punon punëtoria për riparimin e automjeteve të kompanisë. Mirëmbahen te gjitha automjete nder to edhe 4 kamione të Njesise punuese te Vitisë..

Në këtë shërbim janë të punësuar punëtor të profileve të ndryshme siç janë: automekanik, auto elektricist dhe saldues.

Për shkak të shtimit të vëllimit të punëve dhe ngarkesës së automjeteve, defektet janë të shpeshta. Në këtë punëtori rregullohen, defektet nga më të imtat e deri te riparimi i përgjithshëm. Përveç angazhimit të automekanikëve brenda objektit, këta punëtor herë pas here bëjnë intervenime edhe në terren, ndonëse për raste të tilla të angazhohet ekipi lëvizës

Riparimi bëhet sa më racional (shikohet mundësia e eliminimit të defekteve me pjesë të veta të automjetit, nëse nuk është mundësia të riparohet, sigurohen pjesë të gatshme dhe kompletohen).

Riparimi i automjeteve bëhet në përputhje me planin. Afati (orari) për lubrififikim, ngjyrosje dhe hartimi i raportit ditor është detyrë e përditshme.

Njesia është e pajisur me automjete të modeleve të ndryshme dhe firmave më të njoitura siç janë: MAN.

## V. KOSTO E STAFIT DHE MATERIALIT DIREKT-INDIREKT

1. Shpenzimet per Staf direkt .....	61380 .00	euro
2. Shpenzimet e stafit indirekt dhe administrativ.....	88567.48	euro
3. Shpenzimet per lënd djegese dhe materiale .....	70732, 37	euro
3. Shpenzime indirekte dhe administrative .....	13420,34	euro
4. Deponia .....	60176,20	euro
5. Shpemzime mbr.ne pune .....	228,79	euro
6. Investime .....	2652,52	euro

## VI. DEPONIMI I MBETURINAVE

Mbeturinat të cilat grumbullohen gjatë procesit të punës, transportohen në Deponi Sanitare në Velekincë.

Shoferi i kamionit të ngarkuar, me rastin e shkarkimit përkatësisht deponimit të mbeturinave, fillimisht bën matjen në peshore, pastaj bëhet shkarkimi i tyre në punishte. Tarifa për shkarkim e mbeturinave është 8,31 euro, për 1 ton të shkarkuar të përziera dhe 50,00 euro për 1 ton, për mbeturina të rrezikshme.

## VII.TARIFA E DEPONISE DHE NGRITJA E SHERBIMEVE

Tarifa e deponimit dhe ngritja sipas viteve, si vijon;

- Viti 2024 8,31 euro /ton
- Viti 2025 9,31 euro/ ton
- Viti 2026 10,31 euro /ton
- Viti 2027 11,31 euro Ton

Pershkak te rritjes së shpenzimeve të deponisë, Bordi i aksionarve ka miratuar një rritje të sherbimeve si vijon:

- Viti 2024 6,20 Euro per klient te amvisrise
- Viti 2025 6,40 Euro per klient te amvisrise
- Viti 2026 6,60 Euro per klient te amvisrise
- Viti 2027 6,80 Euro per klient te amvisrise

### VIII. RREGULLIMI I KONTEJNERËVE

Rregullimi i kontejnerëve paraqet një punë mjaft të rëndësishme nga se kompania disponon disa qindra kontejner të llojeve të ndryshme, të cilët janë të vendosur në qytete dhe fshatra.

Punëtorët e shërbimit, më së shpeshti kujdesen për ndërrimin e rrotave, rregullimin e kapakëve dhe ngjyrosjen e tyre.

Rregullimi i kontejnerëve për mbeturina, bëhet në objektin e kompanisë, njësi dhe në terren. Detyrë permanente e salduesit është riparimi me kohë i kontejnerëve dhe sipas planit të caktuar.

Ecohigjiena Sh.P.K. Gjilan - Njesia punuese Viti

